



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 60, datë 17.07.2026

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR. RENDOR 7 TË TABELËS SË OBJEKTEVE PËR PËRFORCIM MIRATUAR ME VKB-NË NR.141, DATË 12.11.2021 “PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË TABELËS SË OBJEKTEVE PËR PËRFORCIM, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.137, DATË 28.10.2021”

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015, “Kodit të Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 613, datë 20.10.2021 ”Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Durrës”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik, me propozim të Kryetares së Bashkisë,



KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të numrit rendor 7-të të tabelës së objekteve për përforsim miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.141, datë 12.11.2021 “Për miratimin e ndryshimit të tabelës së objekteve për përforsim, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.137, datë 28.10.2021”.

2. Numri rendor 7-të i tabelës së objekteve për përforcim miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.141, datë 12.11.2021 “Për miratimin e ndryshimit të tabelës së objekteve për përforcim, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.137, datë 28.10.2021”, ndryshon si më poshtë vijon:

TABELA E DETAJIMIT TË FONDIT TË OBJEKTEVE PËR PËRFORCIM							
Nr	Gr.	Kap.	Programi	Llog. ek.	Kodi produktit	Emërtimi i projektit	Fondi në lekë
7	00	1	04960	231	94902AB	Riforcim banese individuale njësia administrative Ishëm të banorëve: Imer Beja, Riza Shima	10,548,255
	00	1	04960	231	94902AB	Mbikqyrje	197,526
	00	1	04960	231	94902AB	Kolaudim	19,094
						TOTALI	10,764,875

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Projekteve Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik, Drejtoria Ligjore, Sektori i Procedurave Ligjore dhe Prokurimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARE

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 20.07.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 566/18 prot.

Durrës, më 27.07.2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.60 datë 17.07.2026 “Për miratimin e ndryshimit të nr. Rendor 7 të tabelës së objekteve për përforsim miratuar me VKB-në nr.141, datë 12.11.2021, “Për miratimin e ndryshimit të tabelës së objekteve për përforsim , bashkëlidhur vendimit të Këshilli Bashkiak nr.137, datë 28.10.2021.”

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”i ndryshuar (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karkater individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

**PREFEKTI
ADRIAN GURRA**

